




Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 18.06.2012

Nr.0201-568

Për: Nexhmedin Arifi, Kryetar i Komunës së Vitisë
Skenderbe Hebibi, Kryesues i Kuvendit të Komunës

Lënda: Përgjigje në kërkesë

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar kërkesën për sqarim, të parashtruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Skenderbe Hebibi, e cila ka të bëjë për ndryshimin dhe plotësimin e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa nga LDD-ja.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, si dhe shtojcën XII të Rregullores 02/2011 Për Fushat e Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, pas shqyrtimit të hollësishëm të kërkesës në fjalë, **konstaton se:**

Ligji për Vetëqeverisje Lokale, konkretisht neni 51.1 dhe 52.1 ka përcaktuar se Kuvendi i Komunës themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës.


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, dhe duke u bazuar në të gjitha të cekurat më lartë, **kërkon** nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, të ndërmarrin veprimet konkrete që përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të gjitha Komitetet tjera, të reflektojnë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmë të nevojshme për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.


Me respekt,

Slobodan Petrović

Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL



Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL,
Drejtorëve të Departamenteve të MAPL-së,
Arkivit të MAPL-së,



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 18.06.2012
Br.0201-568

Za: Nexhmedin Arifi, Gradonačelnik opštine Vitina
Skenderbe Hebibi, Predseavajući skupštine opštine

Predmet: Odgovor na zahtev

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ,primilo je zahtev objašnjenja Br.0201-568, predložen od strane predsedavajućeg skupštine opštine g.Skenderbe Hebibi što se tiče o izmeni i dopuni člana Odbora za politiku i finansije od strane DSD.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokalnoj samoupravi Br.03/Z-040, kao i dodatak XII uredbe 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarva , kao i prema zakonu o lokalnoj samoupravi Br.03/Z 040, nakon detaljnijeg razmatranja gore navedenog zahteva konstatuje :

- Zakon o lokalnoj samoupravi , tačnije član 51.1 i 52.1 određuje da skupština opština osniva Odbor za politiku i finansije kao i Odbor za zajednice kao stalne Odbore. Odbor za politiku i finansije predsedava od strane predseavajućeg skupštine opštine i njen sastav trebalo bi da odražava zastupljenost političkih subjekata u Skupštini opštine.


Ministarsatvo administracije lokalne samouprave prema nadležnostima i odgovornostima definisanih zakonom o lokalnoj samoupravi Br.03/Z-040, kao i prema gore navedenom , zahteva od strane Gradonačelnika opštine kao i od strane Prerdsedavajućeg skupštine opštine Vitina da preduzmu konkretne mere da sastav Odbora za politiku i finansije i svih ostalih odbora da odslikava predstavljenost političkih entiteta u Skupštini opštine

Ministarstvo administracije lokane samouprave posvećeno je da pruža potrebnu pomoć i podršku sa ciljem potpunog sprovođenja ovih dužnosti koje proističu od sprovedljivog zakonodavstva lokalnog upravljanja u Republici Kosovo.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović

Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL



Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL,
Drejtorëve të Departamenteve të MAPL-së,
Arkivit të MAPL-së,*



NYRESE HUZAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES VLADY KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data 31.05.2012
Datum

Tipi i organizatës	Nr. i Lëndës	Gjatësia	Vlera
-III-	0201-568	1	



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kuvendi i Komunës
Data : 30.05.2012
VITI

31-05-2012

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina

01-07/676

MINISTRISË SË ADMINISTRATËS SË PUSHTETIT LOKAL

- Përgjegjësit të Zyrës ligjore.

PRISHTINË

Lënda: Kërkesë për sqarim.

Pas paraqitjes së Kërkesës së koordinatorit të LDD-së në komunën e Vitisë nr.01.-07/243.drejtuar Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Viti,për ndryshimin dhe plotësimin e anëtarit të Komitetit për politik dhe Financa nga LDD-ja.

Nga rezultatet e zgjedhjeve lokale .LDD-ja ka pasur 7.deputet në Kuvendin e Komunës,ndërsa gjatë këtij viti 3 deputet të LDD-së kanë kaluar në LDK.me qrast delegati i LDD-së Hasan Aliu si anëtar i KPF ka kaluar në LDK.

Andaj kërkojm nga ju të na sqaroni se a kanë të drejtë ligjore që LDD-ja të përfaqsohet me dy anëtarë në KPF si trup e përhershme e Kuvendit Komunal në Viti.

Më 30.05.2012
VITI

Kryesuesi i Kuvendit Komunal





Lidhja Demokratike e Dardanisë
Democratic League of Dardania

01-03-2012

01-03-2012

NGA:

LIDHJA DEMOKRATIKE E DARDANISË –(LDD)
DEGA NË VITI

PËR : KRYETARIN E KOMUNËS SË VITISË
KRYETARIN E KUVENDIT KOMUNAL

LËNDA:

KËRKESË

Kërkojmë nga përfaqësuesit më të lartë të institucionit Komunal, si nga Kryetari i Komunës z. Nexhmedin Arifi dhe nga Kryetari i Kuvendit Komunal z. Skenderbe Hebibi, që të bëjnë ndryshimin dhe plotësimin e Komiteteve Obligative dhe jo Obligative në kuadër të Kuvendit Komunal të Vitisë.

Lidhja Demokratike e Dardanisë dega në Viti në mbledhjen e mbajtur me 11.02.2012, ku prezentuan edhe anëtarët e Kryesisë Qendrore, në mes tjerash edhe një herë shqyrtuan pozicionet e anëtarëve të këtyre komiteteve, duke pasur parasysh lëvizjen e anëtarëve të më parshëm nga ky subjekt politik në një subjekt tjetër, dhe se tani më nuk i përfaqësojnë interesat e LDD-së.

Andaj me të drejtë kërkojmë zëvendësimin e tyre dhe propozojmë këta kandidatë për përfaqësime nëpër komitete:

Komiteti për Politik dhe Financa - Kadire Ukshini (zëvendson) Hasan Aliun

Komiteti për Komunitete - Sali Abdullahu

Komiteti për Arsim Kulturë dhe Sport - Bushat Zuka

Komiteti për Planifikim dhe Ruajtje të Ambientit - Musa Murati

Komiteti për Ndërmjetësim - Sadik Rexhepi

Komiteti për Shëndetësi dhe Qështje Sociale - Kushtrim Bekteshi

Komiteti për Auditim të Brendshëm - Kadire Ukshini.

Kërkesa tjetër është për këshilltarët e LDD-së të cilët kanë mandatin nga kjo parti, të inicohet procedura e marrjes së mandateve të cilat i kanë marrun në emër të partisë dhe të njejtit të zëvendsohen me anëtarët e tjerë të radhës. Një veprim i heqjes dorë nga këto mandate do të ishte akt moral dhe njerëzor i tyre në radhë të parë edhe ndaj partisë e veqanërisht ndaj elektoratit.

Gjithashtu si kërkesë e tretë është qështja e zyrës së LDD-së, ku kemi marrun një kërkesë nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sportë me Nr. të Protokollit 12-07/1505 të datës 01.09.2011 për lirim të kësaj zyreje me pretekstin se tani më nuk ka LDD-mirëpo neve po ju dëshmojmë një realitet se lëvizjet e anëtarëve nga një subjekt në tjetrin as një herë nuk pushojnë por kjo nuk do të thotë se nuk funksionon subjekti politik. Andaj bazuar në këtë realitet kërkojmë nga ky organ që të e shqyrtoj kërkesën e tyre dhe të tërhiqet nga kjo kërkesë, pasi që LDD-ja është aktive me të gjitha mekanizmat e saja.


I nderuari zotëri Kryetar i Komunës neve kemi bindje të fortë se kërkesat tona do të i shqyrtoni në mënyr korrekte dhe të drejtë sepse siq jeni të vetëdijshëm për rolin e institucionit më të lartë të Qeverisë Komunale, Ju me anëtarët e këtijë Kuvendi po ashtu edhe ne si parti jemi të vetëdijshëm për rolin dhe detyrat e këtijë institucioni.

Kërkesa të njejta kemi bërë edhe më parë, andaj shpresojmë se këtë herë do të vendosni në mënyrën më të drejtë të mundshme.

Paraprkishtë ju përshëndesim !

Viti 29.02.2012

Kordinatori i degës së LDD-së në Viti


/ Sadik Rexhepi /

